



10-03-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretar@kqz-ks.org www.kqz-ks.org

Nr./Br. 202-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2013 për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendeve Komunale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 10.03.2017, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Znj.HYRIJE MUJA** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga subjekti politik "AKR –Aleanca Kosova e Re" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **znj.Fixhrije Rrustemi**
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Mitrovicë, që ky vendim t'i komunikohet **znj.Hyrije Muja**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

## Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, të datës 03.03.2017, Nr.179/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit znj.Fixhrije Rrustemi pas dorëheqjes së saj të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye se personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, e cila është znj.Hyrije Muja, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 10.03.2017

*Yes*

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

**Valdete Daka**





10-03-2017

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretaristi@kqz-ks.org www.kqz-ks.org

Nr./Br. 201-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2013 për Zëvendësimin e Anëtarëve të Kuvendeve Komunale, më 10.03.2017, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Znj.GENTIANA RAMA** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës -LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **znj.Finesë Hajrizi**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Vushtrri, që ky vendim t'i komunikohet **znj.Gentiana Ramës**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Vushtrri, të datës 23.02.2017, Nr.155/2017, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit znj.Finesë Hajrizi, pas dorëheqjes së saj të parëvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të ndërrimit të vendbanimit (jashtë vendit).

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatës të radhës sipas listës së rënditur, e cila është znj.Gentiana Rama, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 10.03.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

